

Data 29.12.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim transporti për nevojat e OSSH sh.a për një periudhë dy vjecare”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 34144750-0 -
Transportuesi të ngarkesave.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 77,735,459 (shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nentë) All, pa TVSH,

ose

- 802,223.5 (tetëqind e dy mijë e dyqind e njëzet e tre pikë pesë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 29.12.2025, 1 euro = 96.9 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, Objekti i kontrates lidhet me sherbimin e transportit te cilin e perfiton shoqeria OSSH SHA, dhe koordinimi ne ofrimin e ketij sherbimi do te menaxhohet nga DSHM e cila do te administroje kondtraten dhe nevojave te drejtorive/sektoreve/zyrave perkatese do te bashkeveproje me kontraktorin per realizimin e sherbimit. Persa me lart ndarja ne lote do ta nderlikonte dhe veshtiresonte procesin e zbatimit te kontrates duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte veshtiresi per stafin. Per shkak te organizimit dhe marrdhenieve qe ruajne shoqerite me njera tjetren, kjo kontrate nuk mund te ndahet ne lote pasi ne thelb te gjithë artikujt objekt i kontrates i perkasin te njejtës kategori produktësh.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare

e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare të jete në masën **jo me pak se vlera e fondit limit**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nën 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij nëni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymen e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listepagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ku të ketë të pasqyruar të paktën 20 punonjës për muajin e fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit; të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për muajin e fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit punonjësit e mëposhtëm:

- Drejtues teknik Inxhinier Mekanik, 1(nje)
- Drejtues Automjetesh me leje drejtimi kategoria C, 4 (kater)
- Drejtues Automjetesh me leje drejtimi kategoria CE, 4 (kater)
- Automakinist, 2(dy)
- Ekskavatorist, 2(dy)
- Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, 1(nje)
- Ekspert për ndihmën e parë, 1(nje)
- Punonjës i trajnuar për punime në lartësi, 5(pese)
- Punonjës i pajisur me Dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik kategoria III ose më lart, 1(nje)
- Teknik ndërtimi, 1(nje)

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë,

- Për Inxhinierin Mekanik duhet paraqitur diplome, CV, kontratat e punës .
- Për Drejtuesit e automjeteve duhen paraqitur lejet e drejtimit perkatese dhe kontratat e punes.
- Për Automakinistin dhe ekskavatoristin duhen paraqitur deshmite e aftësisë profesionale të lëshuara nga organet kompetente dhe kontratat e punes.

- Për Përgjegjesin për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, Ekspertin për ndihmën e parë duhen paraqitur deshmitë e kualifikimit/trajnimit dhe kontratat e punës.
- Për Punonjësën e trajnuar për punimet në lartësi duhen paraqitur deshmitë e kualifikimit/trajnimit dhe kontratat e punës.
- Për Punonjësën e pajisur me Dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik kategoria III ose me lart duhen paraqitur dëshmia e sigurimit teknik dhe kontrata e punës

Operatori duhet të ketë të paktën 20 punonjes për përdorimin e mjeteve, punimeve të vecanta me to, dhe drejtimin operacional të proceseve si:

- Inxhinier Mekanik duhet si drejtues teknik i operatorit për mbarrvajtjen e proceseve të ndryshme të transportit të mirmbajtjen e makinerive
- Drejtues Automjetesh me leje drejtimi kategoria C duhet për përdorimin e mjeteve të transportit përkatës.
- Drejtues Automjetesh me leje drejtimi kategoria CE duhet për përdorimin e mjeteve të transportit përkatës.
- Automakinisti duhet për përdorimin e mjeteve të transportit përkatës.
- Ekskavatorist duhet për përdorimin e mjeteve përkatës.
- Përgjegjes për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë shërben për sigurimin e jetës dhe ruajtjen e mjeteve.
- Ekspert për ndihmën e parë duhet të japë ndihmën e parë në çdo rast aksidenti në vendin e punës.
- Punonjësit i trajnuar për punime në lartësi duhen për punimet në avarite apo punime remonti në linjat ajrore TL/TM/TU .
- Punonjës i pajisur me Dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik kategoria III ose me lart, duhet për shoqërimin e transportit të materialeve që kanë lartësi dhe për sigurimin e mënjanimin të kontaktit me linjat e ndryshme ajrore.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Rrugor të Mallrave, të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, e lëshuar nga autoriteti kompetent, e cila autorizon ushtrimin e aktivitetit të transportit rrugor të mallrave për llogari të vet dhe/ose për të tretë, përfshirë transportin e ngarkesave të rënda dhe/ose jashtë normave, të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme; të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i mjetit	Sasia
-----	---------------------	-------

1.	Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	4 copë
2.	Kamion me vinç	6 copë
3.	Auto kulle për punime ne lartësi 20 m	4 copë
4.	Vinç jo me te vogel se 150 Ton	2 copë
5.	Trajler	4 cope
6.	Fadrome	4 copë
7.	Ekskavator me Goma	4 copë
8.	Miniekskavator per punime ne zona me hapësire te kufizuar	2 copë
9.	Minifadrome per punime ne zona me hapësire te kufizuar	2 copë
10.	Pick Up per transport stafi teknik	4 copë
11.	Rimorkiator për transport te veçante me kapacitet mbajtës jo me pak se 60 ton.	1 copë
12.	Rimorkiator për transportin e makinerive te renda	1 copë
13.	Mjet per Transport special të tonazhit të rëndë	4 copë

Për mjetet e kërkuara më sipër po japim argumentet e duhura për secilin rast :

Trajler për transportin e shtyllave betonarme me gjatesi te ndryshme nga 9ml deri ne 15 ml, Transformatoreve me fuqi nga 100 kvA deri ne 80 MVA .

Makineria vetshkarkuese me kapacitet 10 ton shërben për shkarkimin e matrialeve elektrike si barabana me përcjelles alumini ,alumin-celik të seksioneve nga 16 deri ne 120 mm; barabana me kablllo me vetëmbajtje të llojeve dhe seksioneve te ndryshme nga 16- 95 mm; kablllo fuqie TL/TM/TU 16- 500 mm; kablllo koaksiale, etj.

Kamioni Vinc për transportimin e matrialeve elektrike të ndryshme si transformator fuqie nga 10-800 kVA, shtylla betonarme dhe druri, paneleve TM /TU të kabinave dhe të nënstacioneve, konstruksione metalike, struktura portalesh të ndryshme, etj,

Autokulle për punime në larësi 20 m për ndihme për punonjësit për punime në linjat ajrore TL/TM/TU në raste difektesh dhe mirmbajtjesh të rrjetit ajror elektrik.

Vinç jo me të vogël se 150 ton, që shërben për transportin e transformatorëve të fuqise të sistemit elektroenergjitik, me fuqi deri 80 MVA, dhe pesha max. deri 100 Ton, etj.

Fadrom për hapjen e kanaleve për vendosjen e kablllove nëntokesore (0.4 kV, 10 kV,20kV, 35kV) për hapjen e

gropave për vendosjen e shtyllave të betonit, shtylla druri ,mbushjen e kanaleve pas shtrimit të kablllove.

Eskavatori për punime në zonat e banuara në qytete rrugë të ngushta e trotuare gjatë punimeve

përdoret zakonisht

për punime emergjente.

Mini – eskavatori përdoret aty ku kërkohet precizion dhe kemi hapsirë të kufizuar dhe kërkohet demtim minimal i zones rrethuese, kur do punohet afër ndërtesave dhe mureve mbajtëse.

Mini- fadroma përdoret pranë kablllove ekzistuese (me rrezik minimal) zakonisht për eliminimin e difekteve të këtyre kablllove .

Pick- up për transportimin e stafit mbeshtetës që punon në makineritë dhe punë të tjera ndihmëse.

Rimoikiatori për transportin të vecanta me kapacitet mbajtës jo me të vogël se 60 ton e transformatorëve dhe matrialeve për Nenstacione.

Rimoikiatori për transportin e makinerive të rënda për transportin e mini fadromës dhe minieskavatorit.

Kriteret teknike janë hartuar nga Grupi i Punës i ngarkuar me urdher të titullarit dhe janë percjelle pranë njesise së prokurimit nepermjet relacionit me nr, 9353 prot date 23.12.2025.

Kjo procedure realizohet ne baze te kerkeses se OSSH sh.a nr. 10627 prot. date 08.10.2025 dhe delegimit te procedures me shkresen nr. 10627/1 prot. date 08.10.2025

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.